



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR ME: PRIMJENI DANA:		11.09.2026	
TIJESIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LENDES BR. PREDMETA	SHTOJCA PRILOB
15-	052/01-47542		



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë :	08.09.2026
Referencë :	
Për:	Daut Azemi – Kyesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit
Nëpërmjet :	Imri Ahmet- Kryetar i Komunës së Lipjanit
Nga:	Shemsi Azemi, Kordinator Komunal për Performancë në Komunën e Lipjanit
Lënda:	Raporti i Performancës së Komunës së Lipjanit për vitin 2025

Sipas vendimit të Kryetarit të Komunës të datës 20.01.2026, nr 1Nr.112/02-3151 është themeluar komisioni për raportim në SMPK, i cili komision në afatit e parapar ka raportuar në MAPL për 16 fushat e SMPK.

SMPK (Sistemi për Menaxhimin e Performancës së Komunave) , bën matjen e performancës së komunave për 16 fusha të ndryshme themelore .

Komuna e Lipjanit në raportin e SMPK, në nivel vendi me 74.²⁰ %, në nivel vendi e radhitur në pozitën e pestë (5) ndërsa në radhitjen e Grandi i performancës nuk jemi kualifikuar për shkak të pasojave që në i ka sjell kontrata Kolektive.

Fushat themelore për të cilat bëhet matja e performancës së komunave në këtë rast edhe të Komunës sonë janë :

Linku : <https://statisticssmpk.rks-gov.net/statistics/0?year=2025&municipality=13>

Rradhitja në nivel vendi sipas Komunave :


Filtro sipas vitit

Zgjedh fushën

2025

Performanca e pergji...

Export



Filtro sipas vitit

2025

Zgjedh fushën

Performanca e përgjithshme

Fshije

Export



Në vazhdim e paraqesim në përmbledhje të përgjithshme performancën e komunës sipas fushave të caktuara, në fushat ku performanca është e lartë, e mesme dhe ku performanca është e ulët.

KOMUNA E LIPJANIT

Përmbledhje e përgjithshme

Performanca e përgjithshme e komunës në 16 fusha të matjes është 74.00%. Fusha me performancën më të lartë është, Kulture , rini dhe Sport , Shërbimet Publike Administrative me 99.60, Planifikimi Hapsinor Lokal 99, Shërbimet Publike 98.20 % Mbrojtja e Mjedisit me 84.60 %, Kujdesi Primar Shëndetsor me 80.80 %, Transparenca Komunale me 80.00 %, Përgjegjshmëria Komunale , 77 %, Arsimi Parauniversitar 69.90 %, Hapsirat Publike 68.90 %. Zhvillimi Ekonomik Lokal 65.70 %, Menagjimi i Fatkeqsive 65 %, Barazia në Punësim , Shërbimet Sociale dhe Familjare 62.40 %. Infrastruktura Rrugore me 56.80 % . Përfaqësimi Gjinator 47.90 % dhe Transporti Publik 30.60.

Komuna ka respektuar kriteret për dokumentimin e të dhënave komunale të cilat janë në nivel të kënaqshëm të prezantimit të referencave të caktuara në formularët e raportimit brenda organeve komunale apo jashtë komunës nga ndërmarrjet publike komunale dhe institucionet tjera lokale. Po ashtu komuna e ka pambushur kriterin e raportimit për të gjithë treguesit e performancës komunale.

PERFORMANCA SIPAS FUSHAVE

Fusha 1. Shërbimet Administrative

Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 98.98, Komuna ka pranuar gjithsej 71148 kërkesa në procedurë administrative të parashtruara nga qytetarët, prej të cilave 70139 janë shqyrtuar apo 98.98%, kurse 1009 e kërkesave nuk janë shqyrtuar, apo kanë mbetur në proces të shqyrtimit. Kërkesat e parashtruara për të cilat ka pasur proces të shqyrtimit administrativ, kanë përfunduar brenda afatit ligjor.

Ne menyre grafike :



Fusha 2. Transparenca komunale

Performanca e përgjithshme në fushën e transparencës është 90%.

2025



SHËRBIMET PUBLIKE A...



Fshije

Export



Fusha 3. Përgjegjshmëria komunale

Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 77% edhe në këtë fushë komuna ka raportuar performancë të lartë se performanca dhe reale. Gjatë fazës së verifikimit të dhënave të dhënat kanë qenë të referuara mirë në dokumente burimore të paraqitura në dokumentin e raportimit nga ana e komunës dhe në referenca të caktuara nga ueb-faqja e komunës apo dokumente tjera.

Filtra sipas vitit


2025

Zgjedh fushën

PËRGJEGJSHMËRIA K...

X Fshije

Report



Fusha 4: Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare

Ndonëse fusha ka kaluar përmes procesit të riorganizimit të treguesve dhe rezultateve, krahasimi i performancës së treguesve në nivel të fushës rezulton me 62.00% . Familje me nevojë të cilave iu është siguruar banimi dhe janë krijuar kushtet për lëshim të banimit social 100.00%, Fëmijë me nevojë për strehim që iu është siguruar strehimi familjar 100%

Vlenë të ceket se këtë tregues zvolon përqindjen , Treguesi: 4.1.1 - Të punësuar me nevoja të veçanta në institucione komunale me 40.38 % dhe Treguesi: 4.1.2 - Zyrtarë Publik të punësuar nga komunitetet jo shumicë në institucionet komunale 9.31 %

Filtro sipas vitit

2025

Zgjedh fushën

BARAZIA NË PUNËSIM,...

Fshije

Export



Fusha 5. Kulturë, Rini dhe Sport

Ndonëse fusha ka pasur riorganizmin në nivel të treguesve, krahasimi i performancës në nivel të fushës për Kulturë, Rini dhe Sport pasqyron lëvizje pozitive, ku për vitin e raportuar rezultati i arritur është 100%

Filtro sipas vitit


2025

Zgjedh fushën

KULTURË, RINI DHE SP...

Fshije

Export



Fusha 6. Menaxhimi i Fatkeqësive Natyrore

Përqindja totale e arritur në këtë fushë është 65%. Niveli i përgjithshëm i realizimit të planit Komunal për menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe të tjera është konstatuar të jetë 65%..



Fusha 7. Planifikimi Hapësinor

Komuna e Lipjanit ka një territor prej 33864,0911 km², apo 1022,8 ha, janë të mbuluara me plane rregulluese të hollësishme. Përqindja e arritur në këtë fushë është 99.00% .

Filtro sipas vitit

2025

Zgjedh fushën

PLANIFIKIMI HAPSINOR...

× Fshije

Export



99%
Mesatarja e performancës për
Lipjan 2025



Fusha 8: Hapësirat publike

Përqindja totale e arritur në këtë fushë është 69.00% dhe është shumë në nivel më të lartë se viti paraprak 2024

Filtro sipas vitit


2025

Zgjedh fushën

HAPËSIRAT PUBLIKE

× Fshije

Export



69%
Mesatarja e performancës për
Lipjan 2025



Fusha 9. Infrastruktura Rrugore

Fusha e Infrastrukturës Rrugore ka pësuar ndryshime në aspektin e përmbajtjes së treguesve, mirepo kranasimi i performances se arritur per vitin e raportuar 57.00 % me performancën e vitit 2024 tregon për një renje të ndjeshme të përqindjes.



Fusha 10. Transporti Publik

Në fushën e Transportit Publik komuna e Lipjanit ka arritur performancë me 31.00%. Arsyeja e ramjes se ketij treguesi qëndron në faktin dhe arsyetimin e Ministries se komunakomuna duhet të dorëzojë Plani komunal për transport publik ose Plani i mobilitetit (planet duhet të jenë të miratuara nga Kuvendi Komunal dhe të formës përfundimtare zyrtare dhe të jenë në fuqi për vitin e raportimit), ku janë të specifikuara aktivitetet për vitin raportues. Në rast se në planin/planet e lartpërmendur/a nuk janë të përfshira aktivitetet e planifikuara për vitin e raportimit, kjo e dhënë duhet të dëshmohet edhe me Planin vjetor të punës së drejtorisë përkatëse, në të cilin duhet të jenë të përfshira të gjitha aktivitetet e raportuara, e dhena merr vlerën 0. Megjithse Komuna e ka dorzuar planin po nuk është marrur parasysh.

Filtro sipas vitit


2025

Zgjedh fushën

TRANSPORTI PUBLIK

Fshije

Export



Fusha 11. Shërbimet Publike

Fusha e shërbimeve publike shënon një rritje 98.00% nëse krahasohet me performancën e vitit 2024.

Filtro sipas vitit

2025

Zgjedh fushën

SHËRBIMET PUBLIKE


Fshije

Export




Fusha 12. Mbrojtja e Mjedisit

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit komuna , ku në vitin e raportimit ka arritur performancë prej 85.00% në raport me performancën e vitit paraprak ka një rënje të lehtë



Fusha 13. Përfaqësimi Gjinator

Është kjo fushë e re, e përbërë prej 3 rezultateve dhe 11 treguesve. Performanca e regjistruar në nivel të fushës është 48%, ka një rënie të lehtë nga performanca në krahasim me vitin 2024.




Fusha 14. Arsimi Para universitar

Performanca e regjistruar në nivel të fushës është 70.00%,. Në krahasim me vitin 2024 ka një rritje të ndieshme .



Fusha 15. Kujdesi Primar Shëndetësor

Është kjo fushë e re, për herë të parë e zbatuar në raportimin e vitit 2023, e përbërë prej 3 rezultateve dhe 7 treguesve. Performanca e regjistruar në nivel të fushës është 81.00%, paraqet një rritje në krahasim me vitin paraprak, dhe njëkohsisht është më e larta në nivel vendi !



Fusha 16. Zhvillimi Ekonomik Lokal

Performanca e regjistruar në nivel të fushës është 66.00%. Plani për zhvillim ekonomik lokal është raportuar si i realizuar, me performancë prej 100%, komuna e ka azhurnuar dhe publikuar listën e pronave publike për dhënie në shfrytëzim me qëllim të mbështetjes së zhvillimit ekonomik, është përmbushur performanca prej 100%, Treguesi: 16.1.4 - Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime)

Filtro sipas vitit

2025

Zgjedh fushën

ZHVILLIMI EKONOMIK ...

Fshije

Export



Raporti përfundimtar I performances për viti 2025 Komuna Lipjan

Filtro sipas vitit

2025

Zgjedh fushën


Performanca e përgji...

Fshije

Export



Nese krasahasojmë shfrytëzimin e Grantit të Performances sipas viteve, shohim se Komuna e Lipjanit performon si e dyta në nivel vendi me 76.6 %



Shuma e përgjithsme që ka fituar komuna sipas viteve është : 4,961,913 euro

